



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet

PALËVE:

AVOKATIT TË POPULLIT, i përfaqësuar nga **Znj. Erinda BALLANCA** (që këtu e më poshtë “AP”)

dhe

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, i përfaqësuar nga **Z. ROBERT GAJDA** (që këtu e më poshtë “KMD”)

Të ndërgjegjshëm për rolin dhe detyrat e rëndësishme që Kushtetuta dhe/ose ligjet organike i ngarkojnë Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

Duke marrë parasysh faktin se institucionet duhet të jenë sa më afër qytetarëve, duke mundësuar shërbimet e tyre;

Në respekt të bashkëpunimit institucional dhe detyrimeve që burojnë nga Rezoluta e Kuvendit për vitin 2015, për forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është institucionalizimi i marrëdhënieve midis palëve, me qëllim, zgjidhjen e konfliktit të konkurimit të kompetencave, që mund të ekzistojnë, ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shkak të përmbajtjes së ligjeve të cilat rregullojnë veprimtarinë e tyre, lehtësimin e shkëmbimit të informacionit e bashkëpunimit midis dy institucioneve, në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut,

fushën e të drejtës për mosdiskriminim dhe barazi në ligj dhe para ligjit, si dhe promovimin e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve, që veprojnë për llogari të saj, në ofrimin e shërbimeve publike.

Neni 2 **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj marrëveshje është ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ligji nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga Diskriminimi", dhe neni 10, dhe 27/1 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Neni 3 **Fushat e bashkëpunimit**

Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, angazhohen të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, për sa vijon:

1. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e trajnimeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjen e stafëve përkatëse lidhur me:
 - a) Kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit, të drejtat e njeriut si dhe standardet më të mira për mbrojtjen dhe promovimin e tyre.
 - b) Kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të drejtën për mosdiskriminim, standartet më të mira për mbrojtjen nga diskriminimi dhe promovimin e kësaj të drejte.
2. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim promovimin e veprimtarisë së tyre dhe që i shërbejnë zbatimit të ligjeve përkatëse.
3. Palët angazhohen të shkëmbejnë në mënyrë të vazhdueshme njohuri dhe praktika të reja, në fushën e të drejtave të njeriut njeriut dhe mosdiskriminimit, dhe veprimtarisë administrative funksionale përkatëse.
4. Palët angazhohen të bashkëpunojnë në ofrimin e ndihmës administrative sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.
5. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për studime apo kërkime me interes të përbashkët, me qëllim përditësimin me praktikatat më të mira të fushës në nivel ndërkombëtar.

Neni 4

Fushat specifike të bashkëpunimit me prioritet

Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, angazhohen të bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë dhe fokus të posaçëm për:

1. Identifikimin e akteve ligjore dhe nënligjore në kundërshtim me Kushtetutën, përmes procedurave administrative që ndjekin, dhe bashkëpunimin për paraqitjen bashkarisht si subjekte të legjitimuara, të kërkesave për shfuqizim në Gjykatë Kushtetuese sipas nenit 134/ç dhe "e" të Kushtetutës, me qëllim arritjen e rezultateve të sukseshme në mbrojtjen kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore nëpërmjet kontrollit kushtetues.
2. Identifikimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, nga KMD si institucioni ndërveprues aktiv pranë gjykatave për shkak të kompetencave ligjore vendimmarrëse administrative, si dhe adresimi dhe bashkëpunimi me AP në raste të tilla.
3. Përcjelljen e kërkesave apo ankesave të subjekteve ankues, tek njëri -tjetri në varësi të juridiksionit dhe kompetencës ligjore që kanë, me qëllim që personave të përfshirë në procedurë ankimi t'u garantohet një strategji mbrojtëse sa më efektive dhe e lehtë që të jetë e mundur, për të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshëm.
4. Plotësimin e standardeve të kërkuara nga *Acquis*, sa i përket procesit të përafrimit të legjislacionit kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit nga administrata publike, me qëllim edukimin dhe ndërgjegjësimin e administratës për rolin kyç në procesin e anëtarësimit.
5. Të koordinojnë punën për të promovuar dhe ndërgjegjësuar respektimin e të drejtave të grupeve më vulnerabël, veçanërisht për mosdiskriminimin.

Neni 5

Të drejtat

Me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj marrëveshje, palët kanë të drejtë:

1. Të marrin pjesë në takime të grupeve të punës të organizuara nga secila prej tyre.
2. Të organizojnë shkëmbime përmes formimit juridik e profesional, në funksion të veprimtarisë përkatëse.

Neni 6

Detyrimet e palëve

Secila nga palët nënshkruese angazhohet në ndjekjen e objektivave dhe detyrimeve të kësaj marrëveshje si më poshtë vijon:

1. Të nxisin sensibilizimin e opinionit publik me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve e në veçanti të drejtës për mosdiskriminim.
2. Të bashkëpunojnë për të bërë propozime, në kuadër të përmirësimeve ligjore e nënligjore në fushat përkatëse të veprimtarisë së tyre.
3. Të koordinojnë punën për një bashkëpunimin sa më efikas në kuadër të garantimit të njohjes së publikut me informacion nga ana e autoriteteve publike me qëllim mbrojtjen e drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të çdo personi nga veprimet e paligjshme, ose të parregullta të administratës publike.

Neni 7

Personi i kontaktit

1. Palët në zbatim të kësaj marrëveshje do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni, si dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresoreose me e-mail, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
4. Palët do të njoftojnë menjëherë në rast se ndryshohet personi i kontaktit.
5. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:
 - a. Për AP-në _____
 - b. Për KMD-në _____

Neni 8

Marrëveshja dhe ndryshimet

1. Kjo marrëveshje përbën të vetmen marrëveshje midis Palëve në lidhje objektin e saj.
2. Çdo shtesë a ndryshim i saj do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të fillojë efekte juridike vetëm pas nënshkrimit nga palët.
3. Asnjë amendament ose ndryshim tjetër i marrëveshjes nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht marrëveshjes dhe të nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i palëve.

4. Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët, sipas marrëveshjes, duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 9 Mirëbesimi

1. Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë marrëveshjesi dhe të zbatohet çdo detyrim që rrjedh nga legjislacioni që lidhet me dokumentacionin e administruar respektivisht.

Neni 10 Dispozitat e fundit

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.
2. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet me afat të pacaktuar. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj marrëveshjeje.
3. Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë AP-sëdhe dy të tjera pranë KMD-së.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet me datë 28, 05, 2018

PËR

**KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

Robert GADA



PËR

AVOKATIN E POPULLIT

Erinda BALLANCA

